

**111 miq,
vlerësime dhe urime,
SHKËLQIM HAJDARI
në 60-vjetorin e lindjes**

BOTIMET TOENA

111 miq,
vlerësime dhe urime,
SHKËLQIM HAJDARI
në 60-vjetorin e lindjes

BOTIMET TOENA

Botuese: Irena Toçi
Botimi i librit u sponsorizua nga Shtëpia Botuese TOENA.

Konsulent: Flori Karaj
Redaktor letrar: Eris Rusi
Korrektore letrare: Valbona Dishmica
Përkujdesja grafike *dhe* kopertina: Gea Qëndro

ISBN 9789928960627

© AUTORI *dhe* BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. "M. Gjollesha", nr. 71, Tiranë 1023
ose K. Postare 1420
Tel.: +355 67 70 70 884
botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
<https://toena.al>

PARATHËNIE

Në të vërtetë, libri që keni në duar, jo rastësisht, është ndryshe nga librat e zakonshëm. Ka të veçantën e tij.

Një libër shkruhet zakonisht nga një autor, i cili përmes ngjarjeve, rrethanave, njerëzve, mjedisit, hapësirës ku është vendosur, krijon një univers ku lëvizin njerëz të ndryshëm.

Pra, ai krijon nga perceptimi i tij, ndjenjat, përjetimet, një botë të veçantë, sjell një mori fatesh njerëzore dhe figurash nga më të ndryshmet, dhe kjo është në vetë perceptimin e shkrimit.

Kjo gjendje është e pranishme dhe kështu ka qenë që në zanafillën e letërsisë.

Ky libër ka një rrjedhë ndryshe.

Nuk ka një autor të vetëm. Janë 111 autorë, të cilët, nga eksperiencia e viteve, prirjet, e kaluara dhe e tashmja, kanë sjellë figurën e një njeriu të vetëm, të cilin e kanë mik, shok, koleg, kanë pasur me të çaste të zakonshme apo dramatike, dhe, si ndodh në jetë, njerëzit e duan të Mirën, të Drejtën dhe të Ndershmen, dhe kundër kësaj dashurie nuk mund të bësh asgjë, nuk mund të fshihet asgjë dhe nuk mund të rrethohet asgjë.

Janë 111 autorë, mund të ishin shumë më tepër, disa herë më shumë se kaq, nëse hapësirat e një libri do të ishin krijuar

të pafundme. Kjo nuk ka të bëjë me asgjë tjetër, veçse me hapësirën që ka krijuar në 60 vitet e tij një njeri, që, nuk e ka parë kurrë botën njerëzore si të përkohshme, që e ka kuptuar që herët se miqësia është njëra nga shenjtëritë e dhuruara që nuk mund të humbasin, dhe ku ndërgjegjja njerëzore luan rolin e primatit, që nuk mund të vetasgjësohet.

Personazhi i këtij libri është Shkëlqim Hajdari, lindur në Laknas, Tiranë, më 5 qershor 1966.

Një emër tepër i njohur, jo si pjesë e dikurshme e drejtësisë së shtetit shqiptar, jo si nëpunës i lartë apo tani si prefekti i kryeqytetit.

Të gjitha këto dhe funksione të tjera janë të gjitha rastësore dhe të dorës së dytë. Ai do të ishte ky që është dhe pa asnjërin prej tyre. Nuk është rritur prej tyre, përkundrazi i ka rritur ato.

E ka bërë më të respektueshëm funksionin që ka pasur, edhe kur i është dashur të përballlet me thyerjen e një bindjeje tjetër, që nuk kishte lidhje me të. Nuk ka synuar kurrë të jetë në qendër, ka pasur bindjen se qendra e së Mirës dhe të Drejtës gjendet gjithandej, e tejpashme, në mënyrë që njerëzit të mos ndihen të humbur në kohë dhe në hapësirë.

Çfarë i bën bashkë 111 autorët në mbresat, kujtimet, shënimet dhe cilësimet e tyre për Shkëlqim Hajdarin?

Po të shikosh me vëmendje emrat e tyre, janë figura të njohura dhe mirëdashëse, në to mund të gjesh të gjithë hartën e Shqipërisë natyrale.

Nga të gjitha trojet, viset, shtetet ku qëndrojmë ende të ndarë. Është një hartë dashurie dhe përkushtimi, pasi, asnjëri prej tyre nuk e ka pasur të largët dhe nuk e ndien të tillë.

Megjithëse banor i Tiranës, në ata që mund të quhen ende “tiranat të vjetër”, ai është në të njëjtën kohë edhe tetovar,

edhe drenicas, edhe vlonjat, kolonjar, toskë, shkodran, i viseve të Plavës dhe të Gucisë, çam i dorës së parë, zajazas, kërçovar, prishtinali apo tropojan.

Harta e “libërshkruesve” është në të njëjtën kohë edhe harta e fiseve shqiptare, pasi aty nuk ka shkelur vetëm këmba e tij, por ka qenë i pranishëm jo thjesht fizikisht.

Këta njerëz, bashkautorë, që si e shkrova më sipër, mund të ishin shumë herë më tepër sepse shumë herë më tepër janë miqtë e Shkëlqim Hajdarit, kanë gjetur te “personazhi” i tyre shumë vlera dhe virtyte të përbashkëta, të cilat janë formuar në vëzhgime të vazhdueshme, kanë zënë truallin e tyre, përmes shumë episodeve nga e cila përbëhet jeta e një njeriu.

Ndoshta cilësia më thelbësore e Shkëlqim Hajdarit është përkushtimi.

Unë vetë, në njohjen e hershme me të, si rrallë herë, e kam parë këtë përkushtim kudo ku kemi qenë bashkë, dhe e kam dëgjuar në bisedat e miqve të përbashkët.

“Më prek dashuria jote për njerëzit, veçanërisht për njerëzit e thjeshtë, të varfër, pa përkrahje dhe pa kushte për të ndërtuar një jetë të denjë për veten dhe familjen”, i shkruan njëri ndër miqtë e hershëm, Agim Fagu, ish-ambasadori ynë i shkëlqyer i Shqipërisë në Londër, pikërisht në kohën e Luftës në Kosovë.

“Ka kujtime e njerëz të veçantë që koha nuk i zbeh dot”, ngulmon shkrimtari Ahmed Prençi.

“Shkëlqimi për mua ka një mirësi që buron nga qetësia e brendisë së tij si njeri, virtyti, të cilin ai e çmon shumë, prandaj është për miqtë e tij si një mundësi për të kuptuar se edhe në vitet e vështira ka mbetur ndër ne akoma dashuri, ndjesi dhe dinjitet”, kujton Abaz Hado.

Shkëlqimi është njeri i përkushtuar ndaj të tjerëve. Është ndër ata që nuk u rri shpirti rehat. Si më thoshte dikur miku ynë i përbashkët, Moikom Zeqo, i cili ishte ndër miqtë e afërt të tij, “Shpirti i Çim Hajdarit është i brujtur nga mirësia. Ai është porta e pambyllur e Mirësisë së Madhe”, dhe ky është një nga përcaktimet më të sakta për “personazhin” tonë, për të cilin, presidenti Bamir Topi (2007-2012) do të shkruante se: “Miqësia me Shkëlqimin nuk u diktua kurrë nga konjuktura... Përgjatë kësaj miqësie e rreth saj, erdhën dhe u futën miq të tjerë në një marrëdhënie që i ka rezistuar kohës...”.

Nëse po mendoja për këtë parafjalë modeste, nuk e di sesi më erdhi mendimi se, nëse do të ishte dashur një libër për mikun tonë të përbashkët, shkruar vetëm nga miqtë e tij në Shqipërinë e Përtej Drinit, me siguri do të kishim pasur rishtas më shumë se 111 autorë.

Këtë e them me bindje të plotë, sepse e kam përjetuar këtë ngushtësi të lidhjes së tij., njohjen e thellë, përcaktimin e qartë, ngulmimin për të bërë më të mirën e mundshme, njohjen deri në imtësi të zhvillimeve në trojet shqiptare, qofshin në veriun e Shqipërisë Londineze apo në hapësirat e tjera.

Kjo ndodh sepse ai është patriot i shkëlqyer. Ndoshta nga të paktët idealistë që nuk ndryshojnë kurrë.

“Që në takimet e para me Shkëlqimin më ka bërë përshtypje përkushtimi i tij i sinqertë ndaj çështjeve kombëtare dhe njohja e thellë e zhvillimeve historike e politike të fundviteve ‘80 dhe ‘90 në të gjitha hapësirat shqiptare.

Kjo ta bën të vështirë të dallosh nëse Shkëlqimi është shqiptar i Shqipërisë, i Kosovës, i Maqedonisë së Veriut, i

Luginës së Preshevës apo i Malit të Zi, sepse ai gjithmonë ka folur e vepruar me ndjenjën e një shqiptari që e sheh kombin si një tërësi”, shkruan në shënimet e tij lideri i shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Ali Ahmeti.

“Shkëlqimin mund ta takosh në Zajas, në shtëpinë e Ali Ahmetit; në Vlorë, në Prekaz, te Kullat e Jasharëve; në Dukagjin, në Tropojë; në Akademinë e Shkencave, në Tiranë; në Plavë apo në jugun e Shqipërisë, në përkujtimin e ngjarjeve gjenocidale ndaj popullit shqiptar të Çamërisë, kudo, e çmoj jashtëzakonisht shumë përkushtimin e tij ndaj çështjes kombëtare shqiptare”, shkruan njëri nga themeltarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ish-ambasadori i Kosovës në Tiranë, Ramiz Lladrovci.

Ndjenja e tij nacionale ndaj vlerave të kombit është një nga pasionet dhe synimet e tij themeltare. Nëse në të gjitha rastet e tjera, edhe kur flitet për çështje të rëndësishme, si analist apo thjesht bashkëbisedues, ai është njeri i qetë, ngulmues, por jo shpërthyes; në debatet për kombin ai është jo thjesht pasionant, por shpërthyes, i rrethuar nga detajet e zhvillimeve, ndjekës deri në imtësi i rrjedhave politike, të hershme apo të tanishme, i shqetësuar nga e sotmja dhe i lartësuar nga e nesërmja.

Ai nuk bën dot ndryshe. Nuk mund të ndash figurën e tij si njeri apo si figurë institucionale nga përkushtimi për vlerat e kombit. Është e pamundur. As nuk duhet ta provosh. Është brujtur i tillë. Një vlerë që e ka transmetuar tek e gjithë familja e tij.

Shkëlqimi si njeri.

Është nga ata njerëz vlere e të cilëve qëndron në virtytin që përcjell. Të qëndrosh me të është e njëjtë si të qëndrosh me vetveten. Është në ata burra, pas ndarjes me të cilët,

nuk të shkon ndërmend të kthesh kokën pas, sepse e di se gjithçka ka qenë e sinqertë, e duhur dhe dashamirëse.

Arkeologu dhe shkencëtari i shquar, Neritan Ceka, në kujtimet e tij, mes të tjerave, do të shkruajë:

“Kur dhe si jam njohur me Shkëlqim Hajdarin?

Kam përshtypjen se kam qenë gjithmonë i njohur me të, siç ndodh me njerëzit me të cilët ke interesa dhe gjykime të përbashkëta.

Së pari për arkeologjinë, të fokusuar në rrethinat e Tiranës, atje ku, si thotë populli: “ullinj të janë që nga koha e Romës së Parë”, pra, e Perandorisë Romake.

Shkëlqimi me fliste gjithmonë për ullinjtë e Tujanit, sa herë që fillonim ditën me një ekspres në bregdetin e Borshit, ku kalonim çdo vit pushimet...”.

Në fakt, gjithçka është e vërtetë. E ndien të afërt, nuk i shkëputesh dot vështrimit të tij ngulmues, e ke të vështirë të ikësh nga debati, ku e folura e tij gjysmë tiranse e vjetër e gjysmë toskërisht të bën të mendohesh se nga është origjina e tij, ndihesh i qetë në qëndrimet e gjata me të, je i sigurt që është punëmbarruar, pasi të ka dhënë fjalën.

Pastaj njihesh me familjen e tij dhe e di se ke të bësh me një familjar të shkëlqyer. Shumë ditë shkonim së bashku me Shkëlqimin dhe Florin të takonim Moikommin kur ishte i shtruar në spital, ato ishin ditët e fundit të tij, por më bënte përshtypje përkujdesja e tij ndaj të sëmurëve, por edhe diskutimet me mikun e shquar për gjëra që nuk kishin të bënin me punën e tij.

Ai është mik i të gjithëve, jashtë politikës. Në të vërtetë, as sot e kësaj dite nuk e di dhe as e kam pyetur ndonjëherë se për cilët voton, më është dukur vogëlsi, por edhe ngaqë miqtë e tij janë nga të gjitha “fushëbetejat” e politikës.

Nuk e di nëse ky është një virtyt i tij i lindur, apo jeta e ka bërë të tillë.

Një njeri, shpirti i të cilit nuk gjen prehje, ky është ai, ditëlindja e të cilit mblodhi 111 nga miqtë e tij të shumtë për të shkruar në këtë libër.

I dashur miku ynë,


Shumë vite më parë, më i shquari shkrimtar i Ruisë, Lev Tosltoi, në ditarin e tij do të shkruante: “Thelbi i çështjes nuk qëndron në përsosmërinë morale, por në procesin e arritjes së saj”.

Ti, i dashur, këtë proces e ke kaluar. Fisnikërisht!

Ta mbash atë, dhe jemi të bindur se kështu do të ndodhë, ky është urimi ynë i përbashkët!

Bedri Zenel Islami





THJESHTËSIA ËSHTË VIRTYT I TË MËDHENJVE

ABAZ HADO
Piktore, Kritik arti

SHKËLQIM HAJDARIN e kam njohur shumë vite më parë prej mikut tonë të përbashkët Pandi Madhi. Në atë kohë ishte prokuror i Apelit dhe kujtoj se duke kaluar nga prokuroria për të shkuar në studio, isha duke u ndarë me Pandin, kur nga tuneli i institucionit po dilte Çimi dhe sa na pa, u afrua dhe u takuam me shumë përzemërsi.

Pandi më kishte folur për të, por realisht pashë një prokuror me një thjeshtësi njerëzore që me kalimin e kohës më bëri të kuptoja se çunat e Shqipërisë së mesme janë të mirësjellshëm, babaxhanë, gojësheqer.

Sa herë jam takuar me të, kam zbuluar përtej këtyre mirësive, një zgjuarsis sa të thellë aq edhe të vërtetë. Jemi takuar edhe me njerëz tjerë në tavolina ku Çim Hajdari do të ishte detyrimisht epiqendra, jo se ishte në krye apo kërkonte protagonizëm, por sepse thithte dhe shpërndante lezetin e muhabetit.

Punët, arsyet, ngarkesat janë detyrime angazhuese, që të japin mundësinë të rrish me njerëzit që do apo të duan ty, për t'i dhënë të përditshmes sonë ato momente miqësore që buronin kur pinim një kafe apo uleshim për më gjatë.

Kur flasim për këtë njeri na kujtohen momentet kur kemi ndarë idetë, kohën, pasionin dhe kam parë dashamirësinë dhe angazhimin e pakursyer që tregonte se nuk je vetëm kur telashet të trokasin në derë. Ai ishte me ty, ashtu si dhe me të tjerë bënte të njëjtën gjë.

Pra kjo është proverbiale te ky shpirtnjeri. Tironsit kanë adetet e doket e veta morale, i dun robtë njëlloj si tenolt e teposhtë.

Miku është mik me poste dhe i thjeshtë, por meriton të njëjtin respekt.

Te Çimi kam parë të shkrirë këtë sjellje fisnike burimore dhe të sinqertë. Dua të them se te ky njeri është themeluar në qenien e tij, futur në thellësi të shpirtit, besimi dhe njohuritë mbi për fenë Islame.

Kjo sigurisht është vlerë shpirtërore e njeriut të pastër, pa vese dhe djallëzi. Pra e thënë drejt, është besimprovës që ta dojë Zotin me besimin e pastër. Ai në disa situata ka qenë pjesëmarrës aktiv kur problemet sociale e kanë kërkuar të jetë prezent.

Çimi për mua ka një mirësi që i buron nga qetësia e brendisë së tij si njeri; virtyt ky që e çmon shumë prandaj dhe është për ne, miqtë e tij, pikë referimi si mundësi ku kuptojmë se edhe në vitet e vështira ka mbetur akoma dashuri, ndjesi dhe dinjitet te burrat e vërtetë.

Në mbyllje, kam dëshirë të vë në pah edhe një aspekt që e plotëson personalitetin e këtij miku të çmuar: Çim Hajdari ka një vlerësim dhe e njeh artin pamor, pasi shpesh jo vetëm

ekspozitat e mia, por edhe shumë veprimtari kulturore, i ndjek me përkushtim dhe ka kërshërinë t'i futet në thellësi analitike.

Kur u emërua së fundmi në postin e rëndësishëm të Prefektit, atë natë ne po flisnim për një aktivitet të Shoqatës "Tirana". Sepse ai siç do Tiranën do edhe Shqipërinë, do edhe njerëzit e të gjitha trevave e mua përherë më ngroh shpirtin miqësia e tij e sinqertë me patriotë të krahinës time, Çamërisë.

Urimet më te bukura në këtë 60-vjetor, mik fisnik, i thjeshtë deri në madhështi!



TRIBUNA E SPORTIT QË U KTHYE NË TRIBUNË TË MIQËSISË

ARTIN KOVAÇI

Menaxher sporti

Njohja ime me Shkëlqim Hajdarin daton rreth 21 vjet më parë, në vitin 2005. Takimi ynë i parë fizik ndodhi pas përfundimit të ndeshjes së futbollit Tirana–Elbasani, që përfundoi me rezultatin 0–0. Ishte një moment i thjeshtë sportiv, por që u kthye në fillimin e një miqësie të gjatë dhe të qëndrueshme ndër vite. Pas ndeshjes, përpara tribunës, takohemi edhe me Refik Halilin e Ferdinand Lleshin.

Që nga ai moment, marrëdhënia jonë erdhi shumë natyrshëm nga një njohje e krijuar në ambientet sportive në një miqësi të sinqertë dhe të qëndrueshme. Gjatë gjithë këtyre viteve kemi ruajtur një respekt dhe mirënjohje të ndërsjellë, si në aspektin familjar, ashtu edhe në atë shoqëror e sportiv. Një rol të rëndësishëm në forcimin e kësaj lidhjeje ka pasur edhe miku ynë i përbashkët, ish-Presidenti i Republikës, Bamir Topi, përmes të cilit takimet tona janë bërë më të shpeshta dhe më të ngrohta. Këto marrëdhënie të përbashkëta në sport, në jetën shoqërore dhe në fusha të

tjera kanë bërë që miqësia jonë të bëhet edhe më e fortë me kalimin e viteve.

Shkëlqimi, apo siç e thërrasim shpesh miqësisht “Çimi”, është një personalitet me formim të gjerë dhe me vlera të veçanta njerëzore. Si ish-prokuror dhe si profesionist i fushës së drejtësisë, ai ka dëshmuar gjithmonë seriozitet, integritet dhe përkushtim në detyrë. Por përtej profesionit, ai mbetet një njeri me dimensione të mëdha humane: i dashur me miqtë, i ndjeshëm ndaj njerëzve në nevojë dhe gjithmonë i gatshëm për të dhënë ndihmë e mbështetje.

Në jetën e tij shquhen cilësi të rëndësishme si humanizmi, bujaria, shpirti miqësor dhe përkushtimi ndaj familjes. Ai është një familjar i devotshëm dhe një njeri që u jep shumë rëndësi vlerave shpirtërore dhe besimit në Zot. Pikërisht këto vlera kanë bërë që lidhjet tona familjare të bëhen gjithnjë e më të afërta, duke ndarë jo vetëm miqësinë, por edhe bindjet dhe parimet e përbashkëta shpirtërore.

Me kalimin e viteve, njohja jonë që filloi në një ambient sportiv u shndërrua në një marrëdhënie të fortë familjare dhe shoqërore. Sot, pas më shumë se dy dekadash miqësie, mund të them me bindje se Shkëlqim Hajdari është një nga ata njerëz që lënë gjurmë të mira te të gjithë ata që e njohin. Ai është një mik i vërtetë, një njeri me zemër të madhe dhe një personalitet që i shërben shoqërisë me dinjitet dhe integritet.

Me këtë rast përvjetori, i uroj mikut tim të dashur, Shkëlqim Hajdarit, shëndet, jetë të gjatë dhe suksese të mëtejshme në çdo hap të jetës së tij! Miqësia jonë, e lindur nga sporti dhe e forcuar nga vlerat njerëzore e shpirtërore, mbetet një pasuri e çmuar që e vlerësoj dhe e ruaj me shumë respekt.



XHAXHI ÇIMI ËSHTË PREFEKT APO PERFEKT

AGIM FAGU

*Basketbollist, Kapiten i ekipit kombëtar të basketbollit,
Pedagog, Deputet, Ambasador*

U njoha me Çimin para rreth 15 vjetësh. Miqësia u rrit ngadalë, shkak i paragjyqimit tim për njerëzit e sistemit të drejtësisë, që, kryesisht për sjelljet e tyre, e kishin ulur shumë vlerësimin për ta në shoqërinë shqiptare.

Ngjarje, fakte, informacione më treguan kohë pas kohe se ai kishte mbërritur në majat e prokurorisë nga një rrugë tjetër, ajo e vështirësive, e pengesave, e profesionalizmit, pa përkrahjen më të vogël, sepse vinte nga shtresat e thjeshta të shoqërisë. Shumë shpejt kishte kuptuar se për të gëzuar jetën që ëndërronte duhej të punonte, luftonte, arsimohej, të sakrifikoje pa u tërhequr, sepse jeta nuk dhurohet, por fitohet.

Kjo e bindi të kuptojë se nuk donte një jetë të privilegjuar, të zbrazët, por një jetë me punë dhe me shumë dashuri për njerëzit dhe atë që bën. Duhet t'i shërbente diçkaje më të

madhe se vetja për të krijuar kuptim, vlerë, dashuri për punën, përmes reflektimit për vizionin që kishte krijuar për jetën.

Por kjo jetë të bën të marrësh edhe goditje (në shoqërinë tonë kjo është e zakonshme). Çimi nuk u tërhoq, mori forcë. Ai refuzoi të frikësohet. Një ditë më tha: “Kam frikë vetëm nëse lejojmë që frikësimet dhe kërcënimet të bëhen normë.”

Në të vërtetë, nëse ke një ëndërr, mbroje atë, lufto shumë që ta bësh atë të vërtetë! Ai kishte vendosur të ishte i lirë. Nuk e pata të vështirë të kuptoja se ishte pajisur me bollëk inteligjence të gjithanshme, madje dekada në kohë më shumë se shumë nga kolegët me të cilët ai punonte.

Vizionar dhe guximtar, për dhjetë vjet, punoi me pasion dhe profesionalizëm për të realizuar përmes vështirësive dhe pengesave, revolucionin (përmbysjen) e sistemit të Inspektoratit Qendror. Një vepër madhore kombëtare, sipas modelit të avancuar perëndimor, tashmë e përfunduar, dorëzuar para tre muajsh në duart e pasardhësve, që duhet ta implementojnë pa gabime e shtrembërime...

Më prek dashuria e tij për njerëzit, veçanërisht për njerëzit e thjeshtë, të varfër, pa përkrahje dhe pa kushte për të ndërtuar një jetë të denjë për veten dhe familjen. Shumë nga këta i kam parë të ndryshuar e të lumtur. Tek Çimi është mishëruar e vërteta universale se “sado qofshin vlerat profesionale ato nuk shkëlqejnë asnjëherë nëse nuk ecin bashkë me ato njerëzore”.

Jam me ty në angazhimin tënd të fundit qytetar për ta transformuar Shoqatën “Tirana” në një shoqatë të denjë për qytetin tonë, Tiranën e tiranasit e vlerave të mrekullueshme njerëzore, qytetare, kulturore e patriotike...

Jam me ty në dashurinë dhe kontributin që ti jep për çështjen kombëtare, dashurinë pa kufi për Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë e Veriun, Çamërinë e trojet tona në Malin e Zi, kudo ku jetojnë shqiptarë.

Mos mendo se harroj familjen tënde, ngushtësisht pjesë e familjes sime, një pasuri e çmuar që, së bashku me Mirën e mirë, keni ndërtuar një familje që kanë trashëguar më të mirat e prindërve të tyre. Ty të pëlqen të theksosh “komandantin”, por mos harro se për edukimin rëndësi më të madhe kanë “komisarët”.

Shpesh bëjmë edhe debate, ndonjëherë s’biem dakord, por mua më pëlqen se diskutimi yt ka “uniformë” imponuese (që tek unë nuk ndryshon gjë), si të një prokurori që harron se po bisedon me një shok.

Në angazhimet e tua pa fund, disa herë ka çështje e njerëz që nuk e meritojnë, sepse të harxhojnë kohë e mund e të bëjnë të mos shijosh realitetin jetësor që të rrethon, i cili ka nevojë për ty. Ka rëndësi të kuptosh “How much is much”.

Këto javë ke filluar një detyrë të re, një angazhim të rëndësishëm në jetën e një zyrtari e qytetari Tiranës. Nipat e mi të vegjël, që të duan dhe i do aq shumë, kur dëgjuan në lajme për emërimin tënd të ri, pyetën: “Xhaxhi Çimi është Prefekt apo Perfekt?”

Me bindje unë u thashë:

“Është Prefekt Perfekt” – Gëzuar Tiranë, e gjete njeriun që kërkoje!



MIQËSIA ME SHKËLQIM HAJDARIN, PLOT ËNDRRA, SFIDA DHE KUJTIME TË PAHARRUESHME

AGIM KOLA

Mjek stomatolog

Njohja ime me mikun tim Shkëlqim Hajdari fillon që në vitet e bukura të jetës së tij studentore, një periudhë plot ëndrra, sfida dhe kujtime të paharrueshme, që mbeten të gjalla në kujtesën time edhe sot. Në atë kohë unë shërbeja si mjek-stomatolog në Shkollën e Lartë të Ministrisë së Brendshme, ku miku im filloi dhe përfundoi studimet e larta. Ishte një ambient i mbushur me energji rinore, me ambicie dhe dëshirë për të ndërtuar të ardhmen, dhe pikërisht në këtë klimë u krijua edhe afrimi i natyrshëm mes nesh.

Pikërisht aty na lindi edhe komunikimi dhe shoqërimi bashkë, që me kalimin e viteve u kthye në një miqësi të fortë dhe të sinqertë. Ishim të dy të rinj, me horizonte të hapura përpara, dhe u rritëm bashkë gjatë këtyre katër vjetëve studentore, të mbushura me përpjekje, sakrificë dhe sfida që na formësuan si njerëz.